




GLADIOLA DONA

Nga Ëndërr në Realitet me Hospitality and Tourism Academy (HAT)

HAT, (Hospitality and Tourism Academy) ka qenë një ëndërr e Gladiola Donës, e cila pas studimeve të bëra në fushën e turizmit jashtë Shqipërisë, rikthehet në vend dhe tërheq pranë vetes miq profesionistë që ndanin të njëjtin pasion me të dhe kështu krijojnë një skuadër të vogël. Ky pasion vazhdon duke shtuar radhët e anëtarëve derisa nisin 4 kurset e para me trajnime për biznese dhe menaxherë në turizëm.

“Dëshira për të aftësuar të rinj, të cilët nuk dinë se si të afrohen me tregun e punës, qoftë këto në Tiranë apo më gjerë”, ishte qëllimi i projekteve që HAT kërkoi mbështetje pranë RisiAlbania.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



Në vitin 2016-2017 nis bashkëpunimi i parë me RisiAlbania në një projekt për trajnimin dhe punësimin e 35 të rinjve në fushën e hotelerisë, shërbimeve në bar dhe restorante. Kurset kanë zgjatur nga 3 deri në 10 muaj, sipas kursit që kanë përzgjedhur të rinjtë. Ky projekt pasohet me ndërtimin e website-it që ofron kurse online, për të përfshirë të gjithë ata studentë që e kanë të pamundur të vijnë fizikisht.

“Me synimin për të arritur një audiencë më të madhe, në vitin 2019, HAT bëhet një nga partnerët në sektorët e turizmit që RisiAlbania mbështet për një platformë profesionale online”, tregon Gladiola.

Kjo platformë do t’i shërbente HAT-it të fillonte kurset e para online të këtij lloji në Shqipëri.

Gladiola tregon se periudha e përfundimit të kursit rakis edhe me mbylljen e ambienteve për shkak të Covid-19, dhe kursantët filluan të ndiqnin kurset online. Gjatë këtyre viteve, kanë marrë trajnim edhe studentë jashtë vendit.

“Kjo ishte një nismë inovatore për Shqipërinë, dhe ishim të parët që i kishim leksionet me video shpjeguese, material për të lexuar, shembuj me foto etj”.

HAT synoi të ketë akses më të madh në trajnime veçanërisht për të rinjtë jashtë Tiranës. Kurset e reja online do të ndihmonin në përmirësimin e aftësive të kërkuara në turizëm. HAT rritet më tej kur zhvillon tregun privat të trajnimit joformal përmes mbështetjes së programeve inovative dhe metodologjive të të mësuarit. Projekti përmirësoi aftësitë dhe rriti punësimin e të rinjve. HAT bashkëpunoi me një nga shkollat kryesore private në botë për Menaxhimin e Hoteleve dhe Mikpritjes, Shkollën e Menaxhimit të Biznesit dhe Hoteleve në Zvicër. Ky partneritet i ka ndihmuar të rinjtë të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre dhe të çojnë rrugët e tyre të karrierës në nivelet më të larta.



Çfarë konsideron sukses Gladiola pas këtyre bashkëpunimeve me RisiAlbania?

“Studentët të cilët kanë marrë pjesë në trajnimet tona nga projektet bashkëpunuese me RisiAlbania, sot janë në poste drejtuese, menaxherë apo edhe menaxherë sektorësh në hoteleri. Ata janë suksesi”.

HAT, sot synon fort në ditët e sotme të ngrejë nivelin profesional të punonjësve në këtë fushë, pritshmëritë e konsumatorëve dhe të vendosë standarde për një sipërmarrje bashkëkohore.

